



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 974/2 Prot.



Fier, më 17/03/2026

**Lënda :** Kërkesë për Shpallje Publike të akteve administrativ (vendimeve të kontabilizimit të detyrimeve doganore)

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

- Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj “**Shpalljen Publike**” për një periudhë kohore jo më pak se 30 (Tridhjetë) ditë të dy akteve administrativ të materializuar ndaj subjektit “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E, me seli në Tiranë (Njesia Bashkiake numër 7, Rruga “Idriz Guri”, pallati Wavini shpk h3 ap 24), – si vijon :

- Vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.29, me nr.577/3 Prot., datë 16/02/2026;
- Vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.30, me nr.577/4 Prot., datë 16/02/2026,

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes publike.

Bashkëngjitur, gjeni kopje të dyë akteve të lartcituara - gjithsej 6 (gjashtë) fletë.

*Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,*

KRYETARI

Eridjol XHAFI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS FIER

Nr.577/3 Prot.

Fier, më 16/02/2026

V E N D I M N r. 29

Sot, më datë 16/02/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022527, nr.2425/5 Prot., datë 07.10.2025, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E, me seli në Tiranë (Njesia Bashkiake numër 7, Rruga “Idriz Guri”, pallati Wavini shpk h3 ap 24),

K O N S T A T O V A S E :

Subjekti “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E dhe seli në Tiranë, është rregjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 21/06/2022 dhe ka si objekt të aktivitetit të tij si vjon : “Import i lëndëve të para për prodhimin e produkteve prej letre. Eksportimi dhe tregtimi i produkteve gjysmë të gatshme dhe të gatshme të industrisë së letrës. Importimi, prodhimi, eksportimi dhe tregtimi në Shqipëri dhe jashtë shtetit i produkteve të kinkalerisë. Prodhimi, përpunimi, importimi, eksportimi dhe tregtimi i produkteve dhe gjysmëprodukteve plastike, etj. Përpunimi i materialeve dhe lëndëve të para tekstile, si prerje, qepje, vendosje aksesorësh, etiketim dhe ambalazhim për çdo lloj produkti tekstil dhe konfeksionesh në sektorin e veshjeve për shërbime fason. Tregtimi i të gjitha mallrave dhe produkteve industriale e bujqësore, brenda dhe jashtë vendit. Punimi i imazheve dhe stampave serigrafike dhe litografike mbi materiale të ndryshme si letër, pëlhurë, tekstil, plastikë, lëkurë, dru, gurë, etj.”.

Subjekti “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr. AL 13817/1, datë 14.09.2022.

Dega e Doganës Fier ka proceduar me shkresën e saj nr.2402 Prot., datë 11/07/2025 me lëndë “Mbi zbatueshmërinë e Udhëzimit nr. 4 datë 28.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”.

Më tej, Dega e Doganës Fier ka proceduar me shkresën nr.2425 Prot., datë 15/07/2025 me lëndë “Program Pune”, sipas të cilit është miratuar ngritja e grupit të punës për verifikimin dokumentar dhe verifikimin e stokut të autorizimit të regjimit të përpunimit aktiv (RPA) nr.13817/1 datë 14.09.2022 dhe nr.24110/1 datë 15.09.2023.

Nga ana e grupit të punës është mbajtur paraprakisht shkresa me lëndë “Proces Verbal” nr.2425/1 Prot., datë 15/07/2025, në të cilin është kryer përkthimi si vijon : “I mbajtur sot më datë 15/07/2025 në ambientet e operatorit ekonomik “Winner’s bag” sh.p.k, me NIPT M24221401E mbajtës i Autorizimit të Përpunimit Aktiv Nr.13817/1 datë 14/09/2022 bazuar nga Programi i Punës me nr.2425 Prot., datë 15/07/2025 grupi i punës ushtroi kontroll mbi verifikimin e mallit lëndë të pare ose të përpunuar (të gatshme) nga ku rezultoi se : Nuk u

gjet asnjë sasi malli që i përket këtij autorizimi”. Ky process verbal është nënshkruar pa rezerva nga administratorja e subjektit.

Më tej, Dega e Doganës Fier ka proceduar me shkresën e saj nr.2425/4 Prot., datë 10/09/2025 me lëndë “Raport mbi programin e punës nr. 2425 prot., datë 15.07.2025”, drejtuar subjektit ku midis të tjerave ka parashtruar si vijon: “Dega e Doganës Fier ju ka informuar me shkresën nr. 2402 Prot., datë 11.07.2025, me lëndë: “Mbi zbatueshmërinë e Udhëzimit nr. 04, datë 28.03.2019, ‘Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv’”, në të cilën jeni vënë në dijeni për shkeljet e kryera nga ana juaj gjatë periudhës së mbajtjes së Autorizimeve të Regjimit të Përpunimit Aktiv. Nga ana juaj nuk është paraqitur asnjë observacion lidhur me gjetjet e Degës Doganore Fier. Sa i takon autorizimit nr. 13817/1, datë 14.09.2022, rezulton se vlera materiale e mallit të eksportuar është më e madhe se vlera e mallit lëndë e parë të importuar, me një diferencë prej 9,320.1 euro më shumë në eksport. Ndërkohë, ju rezultoni me gjendje malli lëndë e parë pa i dhënë destinacion, në sasinë 7,244 kg.

PROCEDURA	VLERA (EURO)	PESHA (KG)
5100 (import)	89,562.7	146,360
3151 (eksport)	98,882.8	139,116
<b>Diferenca (Importe-Eksporte)</b>	<b>-9320.1</b>	<b>7244</b>

Grupi i punës për përlllogaritjet e detyrimeve doganore për këtë diferencë, në pamundësi për të përcaktuar llojin dhe vlerën e mallrave, e ka bërë duke marrë çmimin mesatar të lëndëve të para të importuara në këtë autorizim. Të gjendur në këto kushte, bazuar në Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014, “Kodi Doganor i RSH-së”, sipas nenit 74 “Borxhi doganor i lindur nëpërmjet mospërmbushjes”, nenit 253/b “Mosrespektimi nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1 të nenit 28” dhe nenit 258/1/a, është llogaritur detyrimi në shumën:

Çmimi mesatar është 0.61 euro/kg.

Përlllogaritja e detyrimeve:

Sasia 7244 kg × 0.61 euro/kg × 97.47 kursi = 430,704.33 lekë

Detyrimi = 430,704.33 lekë × 20% = 86,140.8 lekë

Penaliteti = 86,140.8 × trefishi = 258,422.6 lekë

Totali = 344,563.4 lekë

Në vijim, nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore ndaj subjektit është evidentuar një shkelje doganore, e cila është pasqyruar në proces-verbalin e shkeljes, ku në pjesën përshkuese është

parashtruar si vijon: “Bazuar në Raportin mbi Programin e Punës së D.D.Fier nr.2425/4 datë 10.09.2025 operatori ekonomik “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E i pajisur me autorizim RPA nr.13817/1 datë 14.09.2022, ka sasi malli lëndë të pare, pa i dhënë destinacion me peshë 7,244 kg. Kjo sasi nuk u gjend në ambientet e këtij operatori, pas kontrollit të ushtruar nga D.D.Fier. *Kjo shkelje klasifikohet sipas nenit 74, nenit 253/b dhe sanksionohet sipas nenit 258/1/a i Ligjit nr.102/2014 ‘Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë’.*”

Nga ana e grupit të kontrollit, subjekti është shpallur përgjegjës për detyrimin e shmangur në shumën 86,140 (tetëdhjet e gjashtë mijë e njëqind e dyzetë) lekë, si dhe është penalizuar në masën e trefishit të detyrimit doganor të shmangur, në shumën 258,422 (dyqind e pesëdhjet e tetë mijë e katërqind e njëzet e dy) lekë, bazuar në nenin 258/1/a të Kodit Doganor.

Proces-verbali i shkeljes doganore i është njoftuar subjektit me shkresën nr.2425/9 prot., datë 10.10.2025. Nga përmbajtja e proces-verbalit rezulton se shkelja është klasifikuar nga grupi i kontrollit si kundërvajtje administrative, në kuptim të neneve 250/1/a dhe 253 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe sanksionohet sipas nenit 258/1/a të po këtij ligji.

Ndërkohë, autoriteti vendimmarrës, pas njohjes me proces verbalin e lartcitur, ka proceduar me vendimin e ndërmjetëm nr.2425/12 Prot., datë 30/10/2025, me të cilin ka vendosur midis të tjerave si vijon :

*1. Urdhërohet verifikimi fizik i mallrave objekt i dy proces-verbaleve të shkeljes doganore të lartcituara, për të përcaktuar gjendjen e tyre aktuale në magazinat e subjektit “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E, në prani të përfaqësuesve të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore dhe të subjektit.*

*2. Në varësi të rezultatit të verifikimit, të bëhet klasifikimi i shkeljes si më poshtë : Nëse mallrat ndodhen në magazinë → shkelja trajtohet si kundërvajtje administrative sipas neneve 250/1/a dhe 253/b të Kodit Doganor; Nëse mallrat nuk ndodhen në magazinë → procedimi të rikualifikohet si kontrabandë, në zbatim të nenit 268 të Kodit Doganor, me pasojat penale përkatëse.*

*3. Derisa të përfundojë verifikimi fizik, të pezullohet përkohësisht shqyrtimi administrativ i dy proces-verbaleve të shkeljes të lartcitur.*

*4. Ky vendim i ndërmjetëm t’i njoftohet subjektit “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E dhe Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore për zbatim të menjëhershëm.*

Ky vendim i është njoftuar subjektit me anë të shërbimit postar, si dhe me anë të njoftimit elektronik. Në zbatim të vendimit të lartcitur, përgjegjësja e Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore i është drejtuar Zyrës Juridike dhe Titullarit të institucionit më datë 30-01-2026, ku ka përcjellë informacionin përkatës.

Nga verifikimi fizik i ushtruar nga ana e autoritetit doganor, nuk u konstatua prania e sasisë prej 7,244 kg malli lëndë e parë, objekt i autorizimit të regjimit të përpunimit aktiv nr. AL 13817/1, datë 14.09.2022, për të cilën

subjekti rezulton pa i dhënë destinacion doganor. Gjithashtu, subjekti nuk paraqiti dokumentacion justifikues ligjor që të provojë destinacionin e kësaj sasive malli, në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor në fuqi.

Në këto kushte, duke qenë se mallrat objekt verifikimi nuk u gjendën në magazinat e subjektit dhe nuk u provua destinacioni i tyre, autoriteti vendimmarrës çmon se ndodhemi përpara elementëve të veprës së kontrabandës, në kuptim të nenit 268 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

Për pasojë, në zbatim të nenit 268 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, veprimet/mosveprimet e subjektit paraqesin elementë të veprës së shkeljes doganore “kontrabandë”, duke tejkaluar kuadrin e një kundërvajtjeje administrative.

Në përfundim, mbi bazën e fakteve të administruara, dokumentacionit të shqyrtuar dhe rezultateve të kontrollit, autoriteti vendimmarrës arrin në përfundimin se procedimi administrativ i nisur fillimisht si kundërvajtje duhet të rikualifikohet, duke vijuar me ndjekjen e procedurave përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë referimin e çështjes pranë organeve kompetente për vlerësimin e përgjegjësisë penale. Ky vlerësim bëhet në respektim të parimit të ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe mbrojtjes së interesave financiare të shtetit, si dhe në funksion të garantimit të zbatimit korrekt të regjimeve doganore dhe integritetit të sistemit të mbikëqyrjes doganore. Në këto kushte, kualifikimi juridik i kryer nga ana e grupit të punës sipas neneve të cituar në proces verbal (kundërvajtje administrative) rezulton i papërshtatshëm, pasi kjo dispozitë zbatohet kur kemi thjesht mosrespektim procedural të kushteve të autorizimit, ndërsa në rastin konkret kemi mungesë fizike të mallrave dhe shmangie nga kontrolli doganor.

Veprimet e subjektit përbëjnë shkeljen doganore “kontrabandë”, në kuptim të dispozitave të Kodit Doganor që sanksionojnë heqjen e mallrave nga mbikëqyrja doganore dhe futjen e tyre në qarkullim pa përmbushur detyrimet përkatëse. Në këto kushte, kualifikimi juridik i saktë i sjelljes së subjektit nuk është ai i një kundërvajtjeje administrative, por ai i shkeljes doganore “kontrabandë”, neni 266/5, me të gjitha pasojat ligjore që rrjedhin prej saj, përfshirë rillogaritjen e detyrimeve, aplikimin e masave ndëshkimore përkatëse dhe ndjekjen e procedurave sipas natyrës së kësaj shkeljeje. Kualifikimi i bërë fillimisht sipas nenit 253 si kundërvajtje administrative rezulton i gabuar dhe i papërshtatshëm në raport me rrethanat konkrete të çështjes.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”,

#### V E N D O S A :

- Subjekti “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën 86,140 (tetëdhjet e gjashtëmijë e njëqind e dyzetë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS FIER

Nr.577/4 Prot.

Fier, më 16/02/2026

V E N D I M N r. 30

Sot, më datë 16/02/2026, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova Proces - Verbalin e shkeljes doganore me nr.serial 0022529, nr.2425/7 Prot., datë 07.10.2025, i mbajtur nga Grupit i Kontrollit, në ngarkim të subjektit “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E, me seli në Tiranë (Njesia Bashkiake numër 7, Rruga “Idriz Guri”, pallati Wavini shpk h3 ap 24),

K O N S T A T O V A S E :

Subjekti “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E dhe seli në Tiranë, është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 21/06/2022 dhe ka si objekt të aktivitetit të tij si vjon : “Import i lëndëve të para për prodhimin e produkteve prej letre. Eksportimi dhe tregtimi i produkteve gjysmë të gatshme dhe të gatshme të industrisë së letrës. Importimi, prodhimi, eksportimi dhe tregtimi në Shqipëri dhe jashtë shtetit i produkteve të kinkalerisë. Prodhimi, përpunimi, importimi, eksportimi dhe tregtimi i produkteve dhe gjysmëprodukteve plastike, etj. Përpunimi i materialeve dhe lëndëve të para tekstile, si prerje, qepje, vendosje aksesorësh, etiketim dhe ambalazhim për çdo lloj produkti tekstil dhe konfeksionesh në sektorin e veshjeve për shërbime fason. Tregtimi i të gjitha mallrave dhe produkteve industriale e bujqësore, brenda dhe jashtë vendit. Punimi i imazheve dhe stampave serigrafike dhe litografike mbi materiale të ndryshme si letër, pëlhurë, tekstil, plastikë, lëkurë, dru, gurë, etj.”.

Subjekti “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E ka përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv me nr. AL 24110/1, datë 15.09.2023.

Dega e Doganës Fier ka proceduar me shkresën e saj nr.2402 Prot., datë 11/07/2025 me lëndë “Mbi zbatueshmërinë e Udhëzimit nr. 4 datë 28.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”.

Më tej, Dega e Doganës Fier ka proceduar me shkresën nr.2425 Prot., datë 15/07/2025 me lëndë “Program Pune”, sipas të cilit është miratuar ngritja e grupit të punës për verifikimin dokumentar dhe verifikimin e stokut të autorizimit të regjimit të përpunimit aktiv (RPA) nr.13817/1 datë 14.09.2022 dhe nr.24110/1 datë 15.09.2023. Nga ana e grupit të punës është mbajtur paraprakisht shkresa me lëndë “Proces Verbal” nr.2425/2 Prot., datë 15/07/2025, në të cilin është kryer përshkrimi si vijon : “I mbajtur sot më datë 15/07/2025 në ambientet e operatorit ekonomik “Winner’s bag” sh.p.k, me NIPT M24221401E mbajtës i Autorizimit të Përpunimit Aktiv Nr.24110/1 datë 15/09/2023 bazuar nga Programi i Punës me nr.2425 Prot., datë 15/07/2025 grupi i punës ushtroi kontroll mbi verifikimin e mallit lëndë të pare ose të përpunuar (të gatshme) nga ku rezulton se : Nuk u

gjet asnjë sasi malli që i përket këtij autorizimi”. Ky proces verbal është nënshkruar pa rezerva nga administratorja e subjektit.

Më tej, Dega e Doganës Fier ka proceduar me shkresën e saj nr.2425/4 Prot., datë 10/09/2025 me lëndë “Raport mbi programin e punës nr. 2425 prot., datë 15.07.2025”, drejtuar subjektit ku midis të tjerave ka parashtruar si vijon: “..Dega e Doganës Fier ju ka informuar me shkresën nr. 2402 Prot., datë 11.07.2025, me lëndë: “Mbi zbatueshmërinë e Udhëzimit nr. 04, datë 28.03.2019, ‘Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv’”, në të cilën jeni vënë në dijeni për shkeljet e kryera nga ana juaj gjatë periudhës së mbajtjes së Autorizimeve të Regjimit të Përpunimit Aktiv. Nga ana juaj nuk është paraqitur asnjë observacion lidhur me gjetjet e Degës Doganore Fier. Sa i takon autorizimit Nr. 24110/1, datë 15.09.2023, situata nga sistemi Oracle rezulton se keni ende gjendje mall lëndë të parë, pa i dhënë destinacion, në sasinë 26,085.65 kg dhe me vlerë 15,043.77 euro.

PROCEDURA	VLERA (EURO)	PESHA (KG)
5100 (import)	69,157.03	72,665.65
3151 (eksport)	54,113.26	46,580
Diferenca (Importe-Eksporte)	15,043.77	26,085.65

Të gjendur në këto kushte, bazuar në Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014, “Kodi Doganor i RSH-së”, sipas nenit 74 “Borxhi doganor i lindur nëpërmjet mospërbushjes”, nenit 253/b “Mosrespektimi nga personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1 të nenit 28” dhe nenit 258/1/a, është llogaritur detyrimi në shumën:

Përlllogaritja e detyrimeve:

Detyrimi = 15,043 euro × 97.47 kursi × 20% = 293,263.25 lekë

Penaliteti = 293,263.25 × trefishi = 879,789.75 lekë

Totali = 1,173,053 lekë

Në vijim, nga kontrolli i ushtruar nga ana e Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore ndaj subjektit është evidentuar një shkelje doganore, e cila është pasqyruar në proces-verbalin e shkeljes, ku në pjesën përshkuese është parashtruar si vijon: “Bazuar në Raportin mbi Programin e Punës së D.D.Fier nr.2425/4 datë 10.09.2025 operatori ekonomik “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E i pajisur me autorizim RPA nr.13817/1 datë 14.09.2022, ka sasi malli lëndë të parë, pa i dhënë destinacion me peshë 7,244 kg. Kjo sasi nuk u gjend në ambientet e këtij operatori, pas kontrollit të ushtruar nga D.D.Fier. Kjo shkelje klasifikohet sipas nenit 74, nenit 253/b dhe sanksionohet sipas nenit 258/1/a i Ligjit nr.102/2014 ‘Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë’.

Nga ana e grupit të kontrollit, subjekti është shpallur përgjegjës për detyrimin e shmangur në shumën 293,263.25 (dyqind e nëntëdhjet e tremijë e dyqind e gjashtëdhjet e tre pik njëzet e pesë) lekë, si dhe është

- Subjekti “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E, të penalizohet në masën e trefishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 258,422 (dyqind e pesëdhjet e tetëmijë e katërqind e njëzet e dy) lekë, bazuar në nenin 268/2 të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Tërhiqet vëmendja e personelit doganor që, në raste të ngjashme ku konstatohet mungesë fizike e mallrave të vendosura në regjim pezullues, pamundësim i kontrollit doganor, mosdhënie e destinacionit doganor dhe elementë që tregojnë heqje të mallrave nga mbikëqyrja doganore, çështjet të mos trajtohen si kundërvajtje administrative formale, por të analizohen dhe kualifikohen në përputhje me dispozitat që parashikojnë shkeljen doganorë “kontrabandë”, duke zbatuar me rigorozitet legjislacionin doganor në fuqi. Gjithashtu, tërheq vëmendjen e personelit përgjegjës për vonesën në paraqitjen e dokumentacionit dhe përgjigjeve brenda afateve dhe formave të përcaktuara ligjore,
- Në përputhje me nenin 272 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, subjekti ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen administrative të shkeljes së kualifikuar si kontrabandë, nëse plotësohen kriteret e parashikuara nga ky nen.
- Nëse subjekti nuk kërkon zgjidhje administrativ, kundër këtij vendimi, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor, si dhe duke garantuar paraprakisht 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.
- Për vijimin e procedurave të mëtejshme, një kopje e këtij vendimi, së bashku me gjithë dokumentacionin e lartpërmendur, t’i përcillet Departamentit Operativ Hetimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave Tiranë, për veprime të mëtejshme në përputhje me kompetencat ligjore. Për zbatimin e kësaj dispozite ngarkohet Zyra Juridike pranë Degës së Doganës Vlorë.
- Ngarkohet Zyra e Mbikëqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Fier që të njoftojë organin tatimor për këtë vendim, sipas kompetencave ligjore.

**K R Y E T A R**

**Kosta Vjetro**



penalizuar në masën e trefishit të detyrimit doganor të shmangur, në shumën 879,789 (tetëqind e shtatëdhjet e nëntë mijë e shtatëqind e tetëdhjet e nëntë) lekë, bazuar në nenin 258/1/a të Kodit Doganor.

Proces-verbali i shkeljes doganore i është njoftuar subjektit me shkresën nr.2425/9 prot., datë 10.10.2025. Nga përmbajtja e proces-verbalit rezulton se shkelja është klasifikuar nga grupi i kontrollit si kundërvajtje administrative, në kuptim të neneve 250/1/a dhe 253 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe sanksionohet sipas nenit 258/1/a të po këtij ligji.

Ndërkohë, autoriteti vendimmarrës, pas njohjes me proces verbalin e lartcituar, ka proceduar me vendimin e ndërmjetëm nr.2425/12 Prot., datë 30/10/2025, me të cilin ka vendosur midis të tjerave si vijon :

*1. Urdhërohet verifikimi fizik i mallrave objekt i dy proces-verbaleve të shkeljes doganore të lartcituar, për të përcaktuar gjendjen e tyre aktuale në magazinat e subjektit “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E, në prani të përfaqësuesve të Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore dhe të subjektit.*

*2. Në varësi të rezultatit të verifikimit, të bëhet klasifikimi i shkeljes si më poshtë : Nëse mallrat ndodhen në magazinë → shkelja trajtohet si kundërvajtje administrative sipas neneve 250/1/a dhe 253/b të Kodit Doganor; Nëse mallrat nuk ndodhen në magazinë → procedimi të rikualifikohet si kontrabandë, në zbatim të nenit 268 të Kodit Doganor, me pasojat penale përkatëse.*

*3. Derisa të përfundojë verifikimi fizik, të pezullohet përkohësisht shqyrtimi administrativ i dy proces-verbaleve të shkeljes të lartcituar.*

*4. Ky vendim i ndërmjetëm t’i njoftohet subjektit “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E dhe Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore për zbatim të menjëhershëm.*

Ky vendim i është njoftuar subjektit me anë të shërbimit postar, si dhe me anë të njoftimit elektronik. Në zbatim të vendimit të lartcituar, përgjegjësja e Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore i është drejtuar Zyrës Juridike dhe Titullarit të institucionit më datë 30-01-2026, ku ka përcjellë informacionin përkatës.

Nga verifikimi fizik i ushtruar nga ana e autoritetit doganor, nuk u konstatua prania e sasisë prej 26,085.65 kg malli lëndë e parë, objekt i autorizimit të regjimit të përpunimit aktiv nr. AL 24110/1, datë 15.09.2023, për të cilën subjekti rezulton pa i dhënë destinacion doganor. Gjithashtu, subjekti nuk paraqiti dokumentacion justifikues ligjor që të provojë destinacionin e kësaj sasive malli, në përputhje me kërkesat e legjislacionit doganor në fuqi.

Në këto kushte, duke qenë se mallrat objekt verifikimi nuk u gjendën në magazinat e subjektit dhe nuk u provua destinacioni i tyre, autoriteti vendimmarrës çmon se ndodhemi përpara elementëve të veprës së kontrabandës, në kuptim të nenit 268 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

Për pasojë, në zbatim të nenit 268 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, veprimet/mosveprimet e subjektit paraqesin elementë të veprës së shkeljes doganore “kontrabandë”, duke tejkaluar kuadrin e një kundërvajtjeje administrative.

Në përfundim, mbi bazën e fakteve të administruara, dokumentacionit të shqyrtuar dhe rezultateve të kontrollit, autoriteti vendimmarrës arrin në përfundimin se procedimi administrativ i nisur fillimisht si kundërvajtje duhet të rikualifikohet, duke vijuar me ndjekjen e procedurave përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë referimin e çështjes pranë organeve kompetente për vlerësimin e përgjegjësisë penale. Ky vlerësim bëhet në respektim të parimit të ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe mbrojtjes së interesave financiare të shtetit, si dhe në funksion të garantimit të zbatimit korrekt të regjimeve doganore dhe integritetit të sistemit të mbikëqyrjes doganore. Në këto kushte, kualifikimi juridik i kryer nga ana e grupit të punës sipas neneve të cituar në proces verbal (kundërvajtje administrative) rezulton i papërshtatshëm, pasi kjo dispozitë zbatohet kur kemi thjesht mosrespektim procedural të kushteve të autorizimit, ndërsa në rastin konkret kemi mungesë fizike të mallrave dhe shmangie nga kontrolli doganor.

Veprimet e subjektit përbëjnë shkeljen doganore “kontrabandë”, në kuptim të dispozitave të Kodit Doganor që sanksionojnë heqjen e mallrave nga mbikëqyrja doganore dhe futjen e tyre në qarkullim pa përmbushur detyrimet përkatëse. Në këto kushte, kualifikimi juridik i saktë i sjelljes së subjektit nuk është ai i një kundërvajtjeje administrative, por ai i shkeljes doganore “kontrabandë”, neni 266/5, me të gjitha pasojat ligjore që rrjedhin prej saj, përfshirë rillojaritjen e detyrimeve, aplikimin e masave ndëshkimore përkatëse dhe ndjekjen e procedurave sipas natyrës së kësaj shkeljeje. Kualifikimi i bërë fillimisht sipas nenit 253 si kundërvajtje administrative rezulton i gabuar dhe i papërshtatshëm në raport me rrethanat konkrete të çështjes.

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimi nr.4, datë 28.03.2019, “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”,

#### V E N D O S A :

- Subjekti “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **293,263** (dyqind e nëntëdhjet e tremijë e dyqind e gjashtëdhjet e tre) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor.
- Subjekti “Winner’s bag” sh.p.k, me NUIS M24221401E, të penalizohet në masën e trefshit të detyrimit doganor të papaguar në shumën **879,789** (tetëqind e shtatëdhjet e nëntëmijë e shtatëqind e tetëdhjet e nëntë) lekë, bazuar në nenin 268/2 të Kodit Doganor.

- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Tërhiqet vëmendja e personelit doganor që, në raste të ngjashme ku konstatohet mungesë fizike e mallrave të vendosura në regjim pezullues, pamundësim i kontrollit doganor, mosdhënie e destinacionit doganor dhe elementë që tregojnë heqje të mallrave nga mbikëqyrja doganore, çështjet të mos trajtohen si kundërvajtje administrative formale, por të analizohen dhe kualifikohen në përputhje me dispozitat që parashikojnë shkeljen doganore “kontrabandë”, duke zbatuar me rigorozitet legjislationin doganor në fuqi. Gjithashtu, tërheq vëmendjen e personelit përgjegjës për vonesën në paraqitjen e dokumentacionit dhe përgjigjeve brenda afateve dhe formave të përcaktuara ligjore,
- Në përputhje me nenin 272 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, subjekti ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen administrative të shkeljes së kualifikuar si kontrabandë, nëse plotësohen kriteret e parashikuara nga ky nen.
- Nëse subjekti nuk kërkon zgjidhje administrativ, kundër këtij vendimi, i lejohe të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor, si dhe duke garantuar paraprakisht 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.
- Për vijimin e procedurave të mëtejshme, një kopje e këtij vendimi, së bashku me gjithë dokumentacionin e lartpërmendur, t’i përcillet Departamentit Operativ Hetimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave Tiranë, për veprime të mëtejshme në përputhje me kompetencat ligjore. Për zbatimin e kësaj dispozite ngarkohet Zyra Juridike pranë Degës së Doganës Vlorë.
- Ngarkohet Zyra e Mbikëqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Fier që të njoftojë organin tatimor për këtë vendim, sipas kompetencave ligjore.

**K R Y E T A R**

**Kosta Vjero**

